
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJA		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.244 /18	Data: 20.11.2018	

Në bazë të nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Istogut nxjerr :

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Institucioni: Komuna e Istogut

Drejtoria: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

Titulli i vendit të punës : Zyrtar/e i e Lartë për Eficiencë të Energjisë

Numri i Referencës : RN00004042

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Lloji i pozitës: I, karrierës

Orari I plotë: 40 orë në javë

Kategoria Funktionale: Niveli Profesional

Grada: Niveli i koeficient (koeficienti 7.5)

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat

Qëllimi i vendit të punës: Zhvillimi ,planifikimi , zbatimi i legjislacionit, politikave ,strategjitë ,direktivave në fushën eficiences së energjisë .

Detyrat dhe Përgjegjësit :

1. Harton dhe zhvillon planet e punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara ne baze të objektivave të drejtorisë dhe jep rekomandime për realizim për shpenzimin e energjisë.
2. Analizon të dhënat e energjisë të ndërtesave komunale dhe planifikon marrjen e masave për zbatimin e ligjeve dhe direktivave për eficiences te energjisë
3. Ndhmon me dhënien e informacionit financiar në kohë tek zyrtari kryesor administrative , departamenti i financave për te mundësuar monitorimin efektiv të kostove për shpenzime te energjisë.
4. Angazhimi me grupet e brendshme dhe donatoret për të identifikuar, kuptuar dhe adresuar konsumin problematik dhe për të rekomanduar përmirësime në praktikat dhe procedurat e menaxhimit të energjisë në vend duke përfshire ujin ,ngrohjen dhe energjinë.
5. Propozon zgjedhje ideore dhe profesionale për eficience të energjisë për objektet publike që ndërtohen.
6. Kujdeset për zbatimin e planit komunal te veprimit për eficience të energjisë dhe për raportimin në institucionet e vendit.
7. Përgatit dhe ndërmerr fushata edukative për kursimi të energjisë dhe mbrojtje të mjedisit.
8. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi:

- **Shkollimi i kërkuar:** Diplomë Universitare, drejtimet e Fakultetit Teknik si Fakulteti i Makinerisë (Inxhinierisë Mekanike), Elektroteknikës dhe Ndërtimtarisë.

Kushtet e pjesëmarrjes në Rekrutim :

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

Procedura e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Shkathtësitë e kërkuara:

- Përvoja e kërkuar e punës 3 vite;
- Njohuri dhe përvoja në fushën e burimeve të energjisë,
- Njohuri në planifikim dhe menaxhim të punës dhe udhëheqjes
- Shkathtësi në mbledhje të informatave hulumtuese ,dhënien e këshillave
- Njohuri me kompjuter të aplikacioneve të programeve dhe pajisje të teknologjisë
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit

Afati i konkursit : Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Dokumentet e kërkuara : Diploma mbi kualifikimin, diplomat e lëshuara nga institucionet shkollore jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i, dëshmi për përvojën e punës, çertifikata që nuk jeni nën hetime origjinal, dokumenti i identifikimit, ekstrakti i lindjes. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (të punësuarit), si dhe certifikata tjera mbi trajnimet. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr. 100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë "

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen
- Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Menaxheri i Peronelit
Fatmir Bytyçi